

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 14 PRILL 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Sot, pavarësisht zhvillimeve të vrullshme për keq që ka Shqipëria, për të disatën seancë Kryeministri nuk vjen për t'u përgjigjur para deputetëve dhe para qytetarëve shqiptarë për ngjarjet që ndodhin në këtë vend. Po ashtu sot nuk dëgjojmë asnjë prej përfaqësuesve të maxhorancës të përmendë atë që e përmendin në çdo seancë parlamentare për ndodhitë, për ngjarjet dhe për çdo gjë që vjen përtej oqeanit. Sot nuk shikoj asnjë prej përfaqësuesve të maxhorancës t'u flasë dhe t'u bërtasë qytetarëve shqiptarë për raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit, atë që e di i madh dhe i vogël në këtë vend, atë që e di çdo qytetar shqiptar, për korrupsionin, për vjedhjen, për zhvatjen, për çdo gjë që ndodh në këtë vend; për lidhjen e politikës me krimin; për pandëshkueshmërinë në nivele të larta; për mosecjen në mënyrën e duhur dhe të shpejtë të të gjitha proceseve në sistemin gjyqësor; për pamundësinë e sistemit gjyqësor për të goditur korrupsionin dhe lidhjet e krimit në nivele të larta dhe, pa diskutim, ajo që e kemi thënë prej kohësh, që raporti e citon nga raporti i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, që në zgjedhje kishte përfshirje në blerjen e votave, rrjedhje të ndjeshme të të dhënave personale.

Ky sistem gjyqësor, pa diskutim nën ndikimin dhe presionin e qeverisë, në vend që të hetonte personat që i dhanë avantazh të konsiderueshëm Partisë Socialiste, duke rrjedhur të dhënat personale, hetoi gazetarët dhe portalin që publikoi këto të dhëna. Praktikisht, për shkak të qenit në pushtet, thotë raporti, Partia Socialiste pati avantazhe të ndjeshme, që i përdori në zgjedhje. Bashkë me këtë sot një pjesë e madhe apo e vogël, por ata që janë të shpallur ose të kapur deri sot janë deputetë, të cilët kanë mbushur thesin e votave të PS-së. Diferenca e kësaj ane me anën tjetër në zgjedhjet e 25 prillit ishte sa votat e pothuajse dy deputetëve. Dy janë në burg dhe dy të tjerë janë shpallur non grata nga SHBA-të, të cilët kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë (sipas raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, jo më sipas akuzave të njëjës palë apo tjetrës) që të bëjnë diferencën për t'i dhënë maxhorancën kësaj partie, e cila sot praktikisht nuk ka më legjitimitetin moral për t'i qeverisur qytetarët shqiptarë. Duke qenë se nuk e ka më legjitimitetin moral për ta qeverisur këtë vend, qytetarët shqiptarë vetëm këtë javë kanë marrë disa lajme të zeza: rritje të çmimit të energjisë, rritje të taksave, pamundësi për t'ia dalë dhe për të jetuar në këtë vend për shkak të vjedhjes dhe zhvatjes, rritje të çmimeve për të gjitha produktet bazë për fermerët.

Në Shqipëri është bërë e pamundur të jetohet për shkak të kapjes së shtetit nga një grusht njerëzish. Shikoni pak se ku është niveli i kriminalitetit në këtë vend: kriminelë, që nuk kapen dot nga policia, pavarësisht se janë në kërkim dhe disponon të gjithë infrastrukturën e mundshme dhe të gjitha kapacitetet, madje edhe mbështetjen e ndërkombëtarëve. Qytetarët shqiptarë shohin se si në Elbasan dy superkriminelë të kërkuar nga policia, në mes të rrugës gjuajnë kundër njëri-tjetrit. Policia nuk e kap

dot njërin prej tyre ende sot e kësaj dite. Një kriminel e ka kapacitetin të kapë kriminelin tjetër dhe ta vrasë, ndërsa Policia e Shtetit dhe shteti nuk e kanë kapacitetin t'i izolojnë, për shkak se një pjesë të madhe të këtyre banditëve, llumit të shoqërisë shqiptare, i ka përdorur për votat e PSsë dhe për një pjesë të madhe të deputetëve që kanë ardhur në këtë parlament. Si i përgjigjet kjo maxhorancë krizës së vendit dhe alarmit të madh social, që vjen për shkak të varfërisë, për shkak të mungesës së shpresës që kanë shqiptarët? A ka ndonjë reagim real? A ka ndonjë reagim kur ndodhin vrasje, si ajo në mes të autostradës, apo ajo tjetra në Shkodër?

Pothuajse çdo ditë ka lajme, ku Policia e Shtetit është vetëm si agjenci lajmesh. Po, PSja dhe kjo maxhorancë kanë vetëm një reagim, i cili, pa diskutim, i jep krah krimit të organizuar në këtë vend. Në vend që të ashpërsohen masat ndaj krimit dhe ndaj çdo fenomeni, propozohet legalizimi i kanabisit, pra çdo gjë që Shqipëria e ka prodhuar në të zezë, të gjithë infrastrukturën që raporti i mëparshëm i DASH-it e citonte: "Shqipëria është vendburim për prodhimin e kanabisit dhe vendtransit për drogat e forta". Tashmë Shqipëria, me këto kapacitete të mangëta, që nuk e kontrollon dot territorin, propozon që të legalizohet kanabisi, që, pa diskutim, t'i legalizojë të gjitha grupet kriminale që të përfshihen dhe t'ua lehtësojë procesin e prodhimit të kanabisit, se të gjithë pjesën tjetër të infrastrukturës ia ka lehtësuar me kohë. Pa diskutim, pas kësaj vjen një propozim tjetër po aq i rëndë, jua tha dje edhe përfaqësuesi i ambasadës, amnistia fiskale, me qëllim që të gjitha paratë që janë denoncuar nga opozita, nga shoqëria civile dhe nga mediet, të përfshihen, të legalizohen dhe të futen në sistem, sikur kjo bëhet për të lehtësuar të gjithë emigrantët, për të cilët kjo parti nuk është kujtuar deri më sot.

Të gjitha këto, por edhe ky variant i ri i qeverisjes, gjoja me pyetësor janë shëmtitë e të tjera që bën kjo qeveri. Nëse do të kishte një proces real dhe serioz për çështjet që prekin të majtët dhe të djathtët, siç janë këto dy propozimet e fundit të qeverisë, ka vetëm një instrument se si zgjidhet, nëse qytetarët janë pro apo kundër, të shkohet në referendum. Nëse doni të legalizohet kanabisi apo jo, le t'ua propozojmë qytetarëve shqiptarë; nëse duam të ketë amnisti fiskale apo jo, edhe në mënyrë të kufizuar për emigrantët, të cilët i kanë këto para, këto t'i bëjmë me referendum, por kjo të bëhet edhe për çdo çështje tjetër që prek drejtpërdrejt jo vetëm një palë, por themelet e këtij shteti. Pra, le t'ua lëmë realisht qytetarëve në dorë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, jo me pyetësor, as me pyetje Facebook-u. Për këto arsye, pa diskutim, është detyrë e opozitës, por edhe e të gjithë shoqërisë që për të gjithë delegjitimitetin që ka kjo qeveri dhe për mungesën e legjitimitetit moral për të qeverisur një orë e më parë të organizojmë protesta kombëtare, ku të bashkohen të gjithë qytetarët, që të mund të rikthehet vota e lirë, të rikthehet një qeverisje e përgjegjshme, e cila mendon për qytetarët, jo për skema kriminale, ku mendohet vetëm se si të fuqizohen dy apo tre oligarkë, të cilët po kapin gjithçka në këtë vend apo të gjithë personat rrotull Partisë Socialiste. Faleminderit!